




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-4031/15</u>
Dep. <u>03</u>	Prot No. <u>01-4031/15</u>
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>03</u>	Date <u>10.11.2015</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04/11/2015
REFERENC-Ë:	AKK – DPK - DPKPP – 03-03/3324/15
PËR/ZA/TO:	z. Fadil MUZAQI Drejtor i Prokurimit - Komuna Vushtrrisë
CC:	z. Bajram MULAKU Kryetar Komune – Komuna Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të A.K. - Vushtrri”



I nderuar z. MUZAQI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të A.K. - Vushtrri” me numër prokurimi: 644/15/131/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin: “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të A.K. - Vushtrri” me numër prokurimi: 644/15/131/221, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-I/042.

A r s y e t i m

Duke u nisur nga fakti se ka dyshime të bazuara, Agjencia kundër Korrupsion ka autorizuar fillimin e procedurës për parandalimin e korrupsionit në prokurim publik për aktivitetin: “*Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të A.K. - Vushtrri*”. Pas ekzaminimit të dokumentacionit të nevojshëm, të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Agjencia ka ardhur në konstatimet e më poshtme.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, bazuar në nevojën për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve në komunën e tyre, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 26/10/2015. Agjencia kundër Korrupsion ka dyshime të bazuara se Komuna e Vushtrrisë nuk po zbaton legjislacionin e prokurimit publik, mos zbatim i cili mund të shpie në shpërblim me kontratë në baza jo meritore.

Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues gjatë përpilimit të dosjes së tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin për Prokurim Publik.

Në Dosjen e Tenderit “*Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të A.K.- Vushtrri*” Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur sasinë e përafërt të furnizimeve dhe shërbimeve që duhet të prokurohen në aktivitetin e iniciuar. Me rastin e aplikimit “*Kontratë Publike Kornizë*” ku sasinë mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikim i përafërt i sasive duhet të patjetër të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Pastaj gjatë vlerësimit të ofertave Vlera e përgjithshme e kontratave ose vlera e parashikuar e kontratës kornizë duhet të kalkulohet në bazë të çmimeve të artikujve duke shumëzuar me sasinë relevante ose sasinë e përafërta të kërkuara në dosjen e tenderit.

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit në lidhje me vlerësimin e ofertave, Agjencia kundër Korrupsion ka konstatuar se dy nga tre anëtarët e komisionit vlerësues, kanë qenë pjesë e përpilimit të specifikacionit teknik, si përgjegjës të auto parkut nga njësia e kërkesës. Staf i departamentit të kërkesës mundë të përcaktohet që të bëhet anëtarë i komisionit të Hapjes së Tenderëve ose Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve por jo edhe personi/personat të cilët kanë hartuar Specifikacionin Teknik.

Tutje, gjatë ekzaminimit të dokumentacionit në lidhje me vlerësimin e ofertave, Agjencia kundër Korrupsion konstaton se dy nga tre operatorët e ekonomik ofertues nuk kanë paraqitur validitet të tenderit, me këtë rast konstatojmë se autoriteti kontraktues Komuna e Vushtrrisë i ka vlerësuar këto oferta të operatorëve ekonomik pa vlefshmëri të tenderit. Shqetësues mbetet fakti që anëtarët e komisionit në dy rastet tek “*Formulari i Dorëzimit të Tenderit*” i kanë nënshkruar nga prapa formularët, gjë që supozohet se i kanë vërejtur që ofertat nuk janë valide të cilat më



pastaj nuk janë të paraqitura si të tilla në *“Raporti i Komisionit Vlerësues”* Me këtë rast, Autoriteti Kontraktues është dashur që këto dy oferta t’i klasifikoj si të pa përgjegjshme. Gjithashtu njëri nga operatorët ekonomik ka pasur një gabim aritmetik, gabim i cili ka krijuar diferencë më të madhe mes operatorit ekonomik i cili ishte renditur pas tij. Ky element i ka dhënë edhe më shumë mundësi logjike cilësimit të çmimit *“Jo normalisht të ulët”* operatorit ekonomik në fjalë.

Shqetësues për Agjencinë kundër Korrupsion mbetet fakti i çmimeve jo normalisht të ulëta i cili tani për tani, me legjislacionin aktual, nuk është i sanksionuar sa duhet. Fenomeni i çmimeve jo normalisht të ulëta po e dëmton rëndë prokurimin në nivel vendi dhe nuk po lë hapësirë për kualitet të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të realizuara.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik; nenin 26 Rregullorja e Prokurimit; pika 9, Funkcionet e Njesisë së Kërkesës; pika 10, Funkcionet e Departamentit/Njesisë së Prokurimit; pika 28 Validiteti i Tenderit; dhe pika 34 Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të marr hapat e nevojshëm për anulimin e *“Njoftim për Dhënie të Kontratës”* në mënyrë që aktiviteti i prokurimit mos të ecë tutje pas shkeljes së ligjit të Prokurimit Publik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

